



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 28
Prishtinë, më 16 tetor 2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Verica Qeraniq, Valon Ramadani, Andin Hoti, Emilija Rexhepi, Albert Kinolli dhe Ali Lajçi.

Munguan: Mërgim Lushtaku, Avdullah Hoti, Etem Arifi dhe Faton Topalli.

Stafi mbështetës: Mehmet Simnica, Ajet Avdullahu dhe Endrit Rustemi.

Të ftuar: Besnik Osmani, Auditori i Përgjithshëm, ZKA-së, Sherif Sejdiu, kryesues i Bordit -Stacioni i Autobusëve, SHA Prishtinë dhe Emin Sylejmani, u.d i kryeshefit Ekzekutiv - Stacioni i Autobusëve, SHA Prishtinë.

Pjesëmarrësit tjerë: Qerkin Morina, Blerim Kabashi, Vlora Spanca, Enver Beqolli dhe Senver Morina nga ZKA, Blerim Sallahu, Kuvendi i Kosovës, Vatra Qehaja, LVV, Qëndrim Arifi , INPO dhe Diellza Luzha, KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.10.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2017;**
- 4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Stacionit të Autobusëve SH.A. Prishtinë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.10.2018;

Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 5.10.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2017;

Besnik Osmani, tha që Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2017, nxjerrë në pah çështjet që Qeveria, Komunitat dhe organizatat tjera buxhetore duhet t'i adresojnë në mënyrë që të përmirësojnë sistemin e menaxhimit. Ai tha, se i kanë dhënë 1.129 rekomandime, ku pjesa më e madhe janë dhënë për komunitat që përbëjnë mbi gjysmën e tyre. Kemi një përmirësim të opinionëve të auditimeve. Përmirësim të menjëhershëm kërkon sistemi gjyqësor i cili ballafaqohet me një numër të madh të lëndëve të pazgjidhura. Marrëveshjet për shërbime të veçanta nuk janë në përputhje me ligjet në fuqi. Te prokurimet e centralizuara, Qeveria rrezikon të paguaj rreth 3 milion euro për mallrat të cilat janë të kontraktuara, por që nuk janë pranuar. Fusha tjetër është tek Sistemi Informativ Shëndetësor, i cili ka filluar të aplikohet vetëm tek një pjesë e organizatave dhe nëse nuk merren masat e duhura, ky sistem mund të dështojë. Për ndërmarrjet publike, Osmani tha që gjendja është shumë shqetësuese. Opinionet e këtyre ndërmarrjeve publike janë jo të mira dhe në tri ndërmarrje publike është dhënë mohim i opinionit.

Andin Hoti, pyeti se çfarë masash ndërmerr ZKA-ja për rritjen e zbatimit të rekomandimeve si dhe pyeti për bashkëpunimin që ka Zyra Kombëtare me gjyqësorin?

Besnik Osmani, tha se ZKA-ja ka një plan të veprimit për të përmirësuar këtë situatë. Ai tha për çdo raport, në Bibliotekën Kombëtare organizojnë debat për sensibilizim të publikut. Me donatorët kanë një bashkëpunim që organizatat buxhetore të cilat nuk kanë bërë zbatimin e rekomandimeve të mos u jepen donacione dhe shtoi se kemi një marrëveshje me 9 organizata të shoqërisë civile për të rritur presionin e publikut. Me sistemin e drejtësisë kemi pikat e kontaktit dhe çdoherë kur të gjeturat tregojnë që ka elemente të veprës penale, ato i adresojmë në institucionet përkatëse.

Driton Selmanaj: E inkurajoj auditorin që të vazhdojë me punën dhe theksoi se administrata së bashku me përfaqësuesit e ZKA-së kanë bërë disa rekomandime si atë ku Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i rekomandon Seancës Plenare, miratimin e rekomandimeve të dala nga shqyrtimi i Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2017.

-Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Kosovës që të implementojë të gjitha rekomandimet e dala nga Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2017 dhe të raportojë me shkrim në Kuvend në fund të çdo tremujori të vitit 2019, për ecurinë e implementimit të këtyre rekomandimeve. Në veçanti, Kuvendi i Kosovës rekomandon Qeverinë si më poshtë:

1. Brenda tremujorit të parë të vitit 2019 të fillojë procesin e regjistrimit të gjitha pasurive në pronësi të Institucioneve Publike, të cilat nuk janë në regjistrat e pasurisë dhe të përfundojë këtë aktivitet brenda afatit trevjeçar. Procesi i regjistrimit duhet të bëhet sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.
2. Deri në fund të vitit 2018, të hartojë programin e masave dhe të aktiviteteve për zvogëlimin e detyrimeve të papaguara dhe kontingjente dhe ky program të përfshihet në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve Publike, në mënyrë që të reflektohet në Ligjin Vjetor të Buxhetit për tre vitet e ardhshme. Masat duhet të rezultojnë me përmirësimin e dukshëm të disiplinës financiare dhe pagesën e detyrimeve, brenda afateve të përcaktuara ligjore.
3. Marrjen e masave dhe aktiviteteve për përmirësimin e arkëtimit në të gjitha organizatat buxhetore, me qëllim të reduktimit të rrezikut për stabilitetin buxhetor dhe financiar të shtetit dhe që duhet të rezultojë në uljen e ndjeshme të vlerës së paarkëtuar në periudhën e ardhshme tre vjeçare. Kjo nënkupton përveç tjerash, që të bëhet vlerësimi e vjetërsisë së llogarive të arkëtimit, shkaqeve të vonësave dhe probabilitetit të arkëtimit të tyre, rritjen e shkallës së inkasimit dhe që llogaritë e arkëtuara, të cilat vlerësohen si borxhe të këqija, të trajtohen sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

Verica Qeraniq, tha që nuk i ka pranuar materialet në gjuhën serbe për këtë çështje, prandaj tha që nuk mund të votojë, jo për faktin se nuk pajtohet me rekomandimet, por që duhet t'i lexojë në gjuhën serbe, në mënyrë që të vendosë në lidhje me to.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që Raportit Vjetor i Auditimit për vitin 2017 të adresohet për Seancë Plenare, së bashku me rekomandimet e KMFP-së.

4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Stacionit të Autobusëve SH.A. Prishtinë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;

Valon Ramadani. tha që auditori ka dhënë Opinion të Kualifikuar në Raportin e Auditimit të Stacionit të Autobusëve, me komentin se pasqyrat financiare vjetore për vitin 2017, përveç mosvlerësimit të pasurisë joqarkulluese, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Ai tha që auditori ka identifikuar shumë çështje të tjera, që duhet adresuar si: Planifikimi i dobët i të hyrave dhe shpenzimeve në planin e biznesit 2017-2019, ku planifikimi i shpenzimeve të përgjithshme të ndërmarrjes ishte më i lartë sesa të hyrat, mospërputhshmëria mes kuponëve fiskalë të regjistruar nga arka fiskale dhe Z-raporteve të dorëzuara në arkën administrative për të hyrat e shitjes së biletave, vendimi i kryeshefit ekzekutiv për t'i shtuar dy të hyra të reja që nuk ishin të përfshira në rregulloren e Bordit, blerja e mallrave dhe shërbimeve pa procedura të prokurimit, humbjet e bartura vit pas viti si dhe një zbatim i ulët rekomandimeve nga viti paraprak dhe vitet e mëhershme. z. Ramadani tha që kompania ka një gjobë nga administrata tatimore dhe në bazë të cilës është zhvilluar një procedurë disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës dhe në atë vendim thuhet se duhet

të merren masat, si ulje në pozitë, largim i përkohshëm dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës, mirëpo, që ky vendim nuk është respektuar dhe këta zyrtarë janë avancuar në pozita.

Driton Selmanaj, tha që përkundër operimit me humbje të ndërmarrjes, Bordi i Drejtorëve, për vete ka ndarë pagesa për shkak të performancës së mirë. Ai gjithashtu tha, që nuk zhvillohen procedurat e prokurimit, ndërsa janë tejkaluar punësimet për 5 presona. Zyra Kombëtare, ka bërë një punë shumë të mirë që ka filluar auditimin edhe për ndërmarrjet publike sepse po e shohim një anarki totale në menaxhim.

Emilija Rexhepi, pyeti përfaqësuesit e Zyrës Kombëtare të Auditimit, nëse ka ndonjë bazë ligjore që ndërmarrjet edhe kur operojnë me humbje, mund të marrin kompensime shtesë për shkak të performancës.

Albert Kinolli, pyeti nëse këto kompensime për shkak të performancës, kanë ndikuar në tejkalimin e shpenzimeve të përgjithshme, të cilat ishin planifikuar, e të cilat sipas raportit janë rreth rreth 11 për qind.

Sherif Sherifi, theksoi se të gjeturat e auditorit qëndrojnë të gjitha dhe se janë duke i marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre. Lidhur me zyrtarët, ai tha që janë duke u marrë organet e hetuesisë dhe se pa përfunduar hetimet, ata nuk mund të bëjnë asgjë. Ndërsa, në lidhje me performancën, tha që Bordi e ka shkarkuar Kryeshefin Ekzekutiv, mirëpo, Inspektorati i Punës e ka kthyer në punë. Ai tha që kompensimi për shkak të efikasitetit u takon sipas Ligjit të Punës dhe këtë vendim e kanë marrë mbi këtë bazë ligjore, kurse edhe aksionari është pajtuar me këtë vendim.

Vlora Spanca, tha që Ligji për Ndërmarrjet Publike e përcakton kompensimin për performancën vjetore të drejtorëve, mirëpo, që kjo duhet të bëhet pas raportit të auditimit, që nënkupton se ndërmarrja duhet të ketë një performancë pozitive. Ajo tha se edhe në vitin 2016, por edhe në vitin 2017, Ndërmarrja Publike “Stacioni i Autobusëve”, ka operuar me humbje.

Ali Lajçi, theksoi se këtu kemi të bëjmë me keqpërdorime dhe që nuk është e drejtë që Bordi të merr vendim për vetveten. Papërgjegjësia, tha që, jo vetëm në këtë ndërmarrje, por edhe në ndërmarrjet tjera është brengosëse.

Valon Ramadani, propozoi që raporti duhet të shkojë në Seancë Plenare dhe që komisioni këtë rast duhet shikuar mundësinë ligjore për ta adresuar në Prokurori.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që Raportin e Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Stacionit të Autobusëve SHA. Prishtinë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, ta dërgojë në Seancë Plenare, së bashku me rekomandimet e KMFP-së, rekomandime këto, të cilat do të diskutohen në mbledhje e radhës së KMFP-së.

5. Të ndryshme.

Driton Selmanaj, njoftoi deputetët që KMFP-ja ka kërkuar prej Sekretarit që të japin një sqarim në lidhje me shumën e propozuar për auditimin e partive politike. Ai tha, që përgjigjja e tyre nuk ishte në përputhje me atë që Komisioni ka kërkuar, meqenëse përgjigjja bazohet në koston e Projektligjit për financimin e Parive Politike, ndërsa tha që Komisioni Evropian, po bën presion në zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Përfundim

KMFP, vendoi që çështja në lidhje me kërkesën buxhetore për auditimin e raporteve financiare të partive politike, të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Driton Selmanaj